



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1741 datë. 20.12. 2011

Për

“Shfuqizimin e VKD nr.1438 datë 3.11.2010 “Për disa ndryshime në VKD nr. 1346, datë 23.07.2010 “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Eagle Mobile sh.a për ndryshim të aktit administrativ, Vendim nr.1212, datë 31.03.2010 të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 20.12.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Shfuqizimin e VKD nr.1438 datë 3.11.2010 “Për disa ndryshime në VKD nr. 1346, datë 23.07.2010 “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Eagle Mobile sh.a për ndryshim të aktit administrativ, Vendim nr.1212, datë 31.03.2010 të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”

BAZA LIGJORE :

1. Neni 121 e vijues te ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
2. Neni 31 e vijues i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
3. Rregullore per Aksesin dhe Interkoneksionin e miratuar me VKD nr. 1300, date 14.06.2010, e ndryshuar;
4. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.

K Ë SHILL I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e AMC me Nr. 5295 Prot., datë 21. 10. 2011 “Mbi problemet e lindura nga Operatorët Alternativë (OA) në tregun e telekomunikacioneve në Shqipëri”;
2. Shkresa e AMC me Nr. 5295/1 Prot., datë 16. 11. 2011 “Rekomandim mbi vendosjen e tarifave”;
3. Shkresa e Vodafone Albania me Ref: CEO/087/EXH, datë 27. 10. 2011 “Mbi veprimtarinë e operatorëve alternativë që nuk operojnë një rrjet komunikimesh publike”;
4. Shkresa e Albtelecom me Nr. 4989 Prot., datë 04. 11. 2011 “Mbi zbatimin dhe plotësimin e kuadrit rregullator për bartësit”;
5. Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP:
 - VKD Nr.1345, 1346, 1347 datë 23. 07. 2010;
 - VKD Nr. 1348, datë 26. 07. 2010;
 - VKD Nr. 1436, 1437, 1438, 1439, datë 03. 11. 2010si dhe,
6. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen dhe faktet e reja;
7. Bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Me vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP-it - Nr. 1345, 1346, 1347, datë 23. 07. 2010 dhe Nr. 1348, datë 26. 07. 2010, të cilat respektivisht i referohen sipërmarrësve AMC, Eagle Mobile (EM), Vodafone Albania dhe Albtelecom, AKEP-i kishte vendosur që “*tarifa e terminimit të thirrjeve dhe shërbimeve të interkoneksionit të lidhura me terminimin e*

thirrjeve në rrjetet e tyre për thirrjet hyrëse ndërkombëtare, të jenë objekt i negociatave komerciale” .

2. Pas investimit të AKEP për zgjidhjen e disa mosmarrëveshjeve të lindura gjatë negociatave të sipërmarrësve për përcaktimin e tarifave të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, pasi çmoi se *“sipërmarrësit me FNT nuk arritën të administrojnë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme heqjen e masës rregullatore për rregullimin ex-ante të tarifës së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe përcaktimin e saj nëpërmjet negocimit në terma komerciale të pranueshme në mënyrë të dyanshme, si dhe nga natyra e mosmarrëveshjeve të depozituara në AKEP lidhur ngushtësisht me aplikimin e tarifave për thirrjet hyrëse ndërkombëtare”* AKEP-i me vendimet Nr. 1436, 1437, 1438, datë 03. 11. 2010 të Këshillit Drejtues të tij, vendosi që të ndryshonte vendimin e mësipërcituar duke ripërcaktuar që *“tarifa e terminimit të thirrjeve dhe shërbimeve të Interkoneksionit të lidhura me terminimin e thirrjeve në rrjetet e këtyre sipërmarrësve (AMC, V-Al, EM), të jenë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP. Tarifa maksimale e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare (në rrjetet e këtyre sipërmarrësve me FNT), të jetë 10. 50 lek/minuti dhe tarifë 0.31 lek/për thirrje”*. Ndërsa me vendimin Nr. 1439, datë 03. 11. 2010 të Këshillit Drejtues, AKEP-i vendosi që *“AT për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të përcjella nga operatorët e autorizuar nga AKEP-i, të aplikojë të njëjtën tarifë me atë të terminimit të thirrjeve kombëtare”*.
3. Me qëllim zgjidhjen e situatës së krijuar për shkaqet e mësipërcituara, AKEP-i u detyrua të rivendoste nën rregullim tarifat e shërbimeve të interkoneksionit për thirrjet hyrëse ndërkombëtare, megjithëse me vendimet e korrikut 2010 (të cituara më sipër), duke vlerësuar faktorët e analizuar sipas analizës së tregjeve përkatëse dhe mjedisin efektiv konkurrues, kishte vendosur që këto tarifa të mos ishin më nën rregullim dhe të përcaktoheshin nga vetë palët në konditat e interesave reciproke komerciale dhe në zbatim rigoroz të detyrimit ligjor për dhënien e aksesit dhe interkoneksionit çdo sipërmarrësi të autorizuar nga AKEP-i që e gëzonte këtë të drejtë sipas pikës 4 a) të nenit 13 dhe 48 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 *“Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918)*.
4. AKEP në marrjen e vendimeve 1345, 1346 dhe 1347, datë 23.07.2010 në lidhje me trajtimin e tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare ka konsideruar midis të tjerave se:
 - a. shërbimi i tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, është një shërbim që me impakt në tregjet me pakice në shtetet e huaja.
 - b. përfitimet e perdoruesve fundorë nga detyrimi i ofrimit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, janë indirekte dhe janë të lidhura me përfitimin e një sasive me të madhe të thirrjeve hyrëse (megjithëse perdoruesi fundor nuk paguan) por të varuara nga transmetimi i reduktimeve të tarifës së terminimit midis tranzituesve të ndryshëm deri tek operatorët origjinues të këtyre thirrjeve dhe reduktimi nga këta operatorë jashtë RSH i tarifave të thirrjeve drejt Shqipërisë, reduktime të cilat janë jashtë kontrollit të AKEP apo operatorit terminues.

5. Objektivi kryesor në rregullimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe marrdhënieve midis operatorëve është maksimizimi i përfitimeve të përdoruesve fundorë nga konsumi i këtyre shërbimeve. Ri-vendosja, në Nëntor 2010, nën rregullim e tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare për sipërmarrësit me FNT nuk rezulton të ketë patur efekte direkte në tregjet me pakicë në RSH, d.m.th. në investime më të mëdha në ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve me pakicë. Ndërkohë nga operatorët e mëdhenj në RSH, është argumentuar se një ndër faktorët kryesorë që kanë cuar në rënien e ndjeshme të të ardhurave të tregut të komunikimeve elektronike ka qënë pikërisht rregullimi i tarifës së këtyre thirrjeve dhe reduktimi i ndjeshëm i tyre. Reduktimi i të ardhurave të sektorit ndikon negativisht edhe në stimujt e operatorëve për investime në rrjete dhe shërbime të reja.
6. Në këto kushte, lind nevoja e rivlerësimit nga ana e AKEP-it të disa aspekteve të kuadrit rregullator të përcaktuar prej tij në zbatim të ligjit nr. 9918 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij si dhe të masës rregullatore për vendosjen nën rregullim të tarifës për thirrjet hyrëse ndërkombëtare që terminohen në rrjetet e sipërmarrësëve me FNT.
7. Lidhur me tarifat për thirrjet hyrëse ndërkombëtare, duke çmuar rrethanat dhe arsyet e cituara më sipër, me qëllim nxitjen e investimeve efçente në infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe zhvillimet e reja teknologjike për një cilësi të lartë të produkteve të tyre si dhe duke iu referuar të njejtave fakte dhe arsyetime të parashtruara në vendimet Nr. 1345, 1346, 1347, datë 23. 07. 2010 dhe Nr. 1348, datë 26. 07. 2010, AKEP gjykon se është i nevojshëm:
 - Rivendosja nga ana e AKEP-it e qëndrimit për nxjerrjen jashtë rregullimit të tarifave të terminimit të thirrjeve dhe shërbimeve të interkoneksionit të lidhura me terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre për thirrjet hyrëse ndërkombëtare, për sipërmarrësit me FNT, sipas vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP-it - Nr. 1345, 1346, 1347, datë 23. 07. 2010 dhe Nr. 1348, datë 26. 07. 2010.
 - Tarifat e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të vendosen nga palët në marrëveshje mbi bazën e respektimit të parimit të lirisë kontraktuale dhe të proporcionalitetit të interesave reciproke komerciale për të mos shkaktuar dëm të shpërpjestuar të interesave të tyre.
 - Shfuqizimi i vendimeve nr. Nr. 1436, 1437, 1438, 1439 datë 03. 11. 2010 të Këshillit Drejtues të AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Në mbështetje të pikes 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918 dhe shkronjes e) të pikes 1 dhe pikës 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme, si dhe në zbatim të kompetencave

ligjore të përcaktuar në shkronjat a) dhe b) të nenit 8 të ligjit nr. 9918 me qëllim përmbushjen e objektivave rregullatore të përcaktara në shkronjat ç) dhe dh), të nenit 7 të këtij ligji,

V E N D O S:

1. Shfuqizimin e VKD nr.1438, date 3.11.2010 “Për disa ndryshime në VKD nr. 1346, datë 23.07.2010 “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Eagle Mobile sh.a për ndryshim të aktit administrativ, Vendim nr.1212, datë 31.03.2010 të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese” dhe rivendosjen në fuqi të shkronjës b) ii të pikës 2 të dispozitivit të VKD nr.1346, datë 23. 07. 2010 si dhe ndryshimin e shkronjës ‘c’ të pikës 2 të dispozitivit të VKD nr.1346, datë 23. 07. 2010, si më poshtë:

“Detyrimet aktuale te Eagle Mobile per tarifen e terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare shfuqizohen. Heqja e ketyre detyrimeve behet efektive me 1.02.2012”.

2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURCE